VENDIM
Nr.173, datë 31.5.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO SPORT"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicendimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit "Radio Sport" sh.p.k., dhe propozimin për rinovim licence të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Sport", në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 21.10.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati